

ThiovitJet® 80 WG

Lënda vepruese:	Squfur
PËRMBAJTJA:	Squfur: 80% Lëndë ndihmëse: 20%
Numri i regjistrimit:	152/1-14.11.2008
Formulimi:	Granula të dispergueshme në ujë

FUNGICID KONTAKTI ME VEPRIM PARAMBROJTËS

PËRDORIMI:

PEMË FRUTORE FARORE: Hiri 400 gr para lulëzimit, 200 –300 gr pas lulëzimit. **Kroma** 500 gr. Spërkatja e parë bëhet në fazën e majës jeshile të sythit, e dyta në fazën e majës rozë dhe e treta kur janë rrëzuar petlat dhe kur kushtet favorizojnë zhvillimin e sëmundjeve.

PEMË FRUTORE BËRTHAMORE: Hiri 500 -600 gr para lulëzimit, 300 –400 gr pas lulëzimit. Spërkatje parambrojtëse në fazat e rrëzimit të petlave, shkëputjes së lules nga fruti, kur fruti dallohet qartë dhe kur kushtet favorizojnë zhvillimin e sëmundjeve.

HARDHI: Hiri 200-400 gr para lulëzimit, 100 –200 gr pas lulëzimit. Spërkatjet parambrojtëse bëhen: a) kur lastari ka arritur 10 cm, b) gjatë lulëzimit, c) pas lidhjes së kokrrave, d) çdo 10 – 15 ditë deri në fazën e shkëlqimit të kokrrës dhe në vartësi të intensitetit të infeksionit.

Këpusha e hardhisë 1000 gr. Spërkatje në fazën e çeljes së sythave.

PERIME: Hiri 200-300 gr. Spërkatje me shfaqjen e simptomave të para dhe që përseriten në vartësi me zhvillimin e sëmundjes çdo 10 – 15 ditë

TRENDAFILI: Hiri 200-300 gr. Spërkatje parambrojtëse kur kushtet favorizojnë zhvillimin e sëmundjeve, kur lastarët kanë arritur 10 –15 cm gjatësi dhe që përseriten në vartësi me intensitetin e sëmundjes.

VËREJTJE:

1. Doza është në vartësi të intensitetit të sëmundjes dhe fazës fenologjike të bimëve.
2. Squfuri ka veprim mesatar kundër merimangave.
3. Squfuri nuk vepron në temperatura nën 18°C. Vepron më mire në temperatura mbi 20°C.

FITOTOKSICITETI: Në temperatura të larta (mbi 28°C) paraqiten shënja djegieje. Squfuri mund të paraqesi fitotoksicitet në kungulloret dhe në disa varietete molle, dardhe dhe kumbulle.

PËRZIHET me shumicën e pesticideve të zakonshme. Nuk përziehët me vajra minerale dhe me preparate me reaksion bazik.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: 5 ditë.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet

MASAT PARAMBROJTËSE

-Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.-Ruajeni larg ushqimeve, pijeve dhe ushqimeve për blektorinë - Evitoni thithjen e pluhurit ose tretësirës spërkatëse.-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën.-Vishni rroba të përshtatshme, doreza, syze ose maska për mbrojtjen e syve dhe fytyrës. -Mbani larg zonës së spërkatur personat që nuk kanë punë.-Hiqni menjëherë rrobat e ndotura dhe i lani para se ti ripërdorni. -Mos rritni dozat. -Lani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani, të pini lëngje dhe duhan, si dhe pas përfundimit të spërkatjes.-Mos spërkatni në drejtim të kundërt me erën.-Mos ripërdorni ambalazhet e boshatisura dhe i asgjësoni ato sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni. -Në rast kontakti të preparatit me sytë i lani ato me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe kërkoni këshillë mjekësore. -Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. -Në rast qëllitje jepini në mënyrë të përsëritur karbon aktiv dhe ujë të bollshëm. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i treguni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.
Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



Helmues në rast qëllitje.



NUK ËSHTË HELMUES PËR BLETËT DHE ORGANIZMAT UJORE.
Mos ndotni ujrat me preparatin, tretësirën spërkatëse ose me ambalazhin bosh.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Crop Protection AG,
Basel, Switzerland
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax:+41 61 323 12 12